

TIRANE- Seanca e parë parlamentare e drejtuar pas tetë vitesh nga ana e demokratëve, tashmë fatkeqësisht në pushtet, dje ka degjeneruar në shkelje dhe dhunim të opozitës. Në vend që t'u përgjigjeshin një për një të gjitha pyetjeve, duke cituar jo vetëm pyetjen por edhe emrin e deputetit apo grupit parlamentar, zv.kryeministri I dekretuar ka dalë mbrëmë dhe në vend të kryeministrit të dekretuar Berisha ka filluar logjet, duke ironizuar dhe duke mos ju përgjigjur asnjë lloj pyetjeje. Kjo ka sjellë reagimin e kryetarit të grupit parlamentar socialist, Gramoz Ruci, I cili ka bërë të ditur braktisjen e sallës së parlamentit për sa kohë nuk u jepej përgjigjje pyetjeve të socialistëve. "Zonja drejtuese e seancës. Më vjen keq që seanca e parë e Parlamentit fillon me një dhunim të së drejtës së deputetit, me një dhunim të rregullores së parlamentit. Natyrshëm rregullorja e parlamentit përcakton qartë dhe saktë se cdo deputet ka të drejtë t'i bëjë pyetje kryeministrit, apo anëtarëve të tjerë të Këshillit të Ministrave. Këto pyetje, të cilat nga grupi parlamentar socialist, e them për opinionin publik, janë individuale, janë me emër të deputetit, janë me një objekt të caktuar. I janë drejtuar Kryeministrit, I janë drejtuar Ministrit. Është e drejtë ekskluzive e kryeministrit që edhe mund t'i ndajë ato, por absolutisht është e padrejtë të ironizohen pyetjet apo autorët e tyre, të mos u përgjigjet pyetjeve dhe madje të mos lexohet pyetja. Duhet të lexohet pyetja dhe emri I deputetit apo I grupit parlamentar që e ka bërë dhe përgjigjet ju jepini si të doni.

Grupi parlamentar I PS ka bërë 185 pyetje. Nëse nuk lexohen një për një pyetjet, përgjigjeni apo nuk përgjigjeni ju është detyra juaj, I përgjigjeni mbarë apo mbrapsht është përsëri përgjegjësia juaj, ne duam që pyetjet të fillojnë përsëri nga fillimi. Ndryshe, në seancën tallëse, ironike, të papërgjegjshme të zv.kryeministrit të dekretuar, ne largohemi nga salla dhe do të vijmë për debatin. Mirupafshim", ka qënë deklarata e kryetarit të grupit parlamentar të PS, Gramoz Ruci, dje në parlament, pas fjalës së të cilit grupi socialist ka dalë nga salla. Kryetarja e Parlamentit, Topalli thotë se është e drejtë mosleximi I emrave, ndërkohe që deputei Lesi dhe kryetari I grupit parlamentar të LSI, Sabit Brokaj kanë deklaruar se seanca po degjeneron në një mënyrë të

paparashikuar dhe se duhet të lexohen jo vetëm pyetjet një për një për t'u dhënë përgjigje, por duhet të lexohet edhe emri i deputetit apo grupit parlamentar që bën pyetjen. Seanca e pyetjeve ka qënë një monolog i ministrave të PD, që nuk kanë dhënë asnjë shpjegim për pyetjet që u janë bërë.

S.Vuciterna

Ja pyetjet e Grupit Parlamentar dhe deputeteve të PS të cilave berisha nuk u dha përgjigje

Pyetje të Grupit Parlamentar të PSSH

1. Pyetje për çdo ministër: Cila është struktura e ministrisë: i) organigrama, ii) emrat e drejtorëve; iii) numri i punonjësve dhe iv) zeri në buxhet për paga, sigurime shoqërore dhe shpenzime administrative, për periudhën shtator-dhjetor 2005 (sipas programit të PD); kjo pyetje shtrohet vecanërisht për Ministrinë e Brëndshme; Ministrinë e Transporteve, dhe ministrinë e tjera të bashkuara,
2. Cfarë do të bëhet me Shish? A do të ndryshohet ligji për Shish? Kur?
3. Cfarë do të bëhet me Departamentin e Administratës Publike; A do të ndryshohet ligji për DAP? Kur?
4. Sa është numri i punonjësve që do të dalin të tepërt nga ristrukturimi i ministrive; Cfarë do të bëhet në këtë rast me të gjithë punonjësit që gëzojnë statusin e nëpunësit civil;
5. A do të ketë prekje/transferim të Institutit të Statistikave; me çfarë akti ligjor dhe kur?
6. Pyetje për çdo ministër: Cila janë drejtimet dhe veprimet kryesore në vitin 2007, 2008 dhe 2009 në përputhje me misionin e dikasterit që drejton?
7. Cila është axhenda e veprimeve për anëtarësim në NATO e BE, në vitin 2006, në 2007, 2008 dhe 2009;
8. Cfarë veprimesh parashikohen në vitet 2006, 2007, 2008 dhe 2009 për levizjen e lire të qytetarëve;
9. Cfarë do të bëhet me Albtelekom dhe privatizimet e tjera strategjike?; Kur do të privatizohet ARMO?
10. Në cilën periudhë ka programuar maxhoranca të fillojë veprimin për kryerjen e reformës zgjedhore dhe më konkretisht për përmirësimin e Kodit Zgjedhor për zgjedhjet e përgjithshme dhe vendore?
11. Kur është programuar përfundimi i kartës së identitetit për shtetasit shqiptar?
12. Cila do të jetë strukturat që do të trajtojnë çështjet e minoriteteve?

13. Cila është struktura që do të trajtojë çështjet e diasporës dhe të shqiptarve jashtë Shqipërisë?

14. Ju deklaroheni se do të krijohen të gjithë kushtet e përcaktuara për kuvendin; pyetje: Cfarë programi ka dhe kur fillon/mbaron për përmirësimin e kushteve të punës në Kuvend: i) sallat e komisioneve; ii) sallat e grupeve parlamentare; iii) komunikimi elektronik; iv) sallat e punës për deputetët; v) biblioteka, e tjerë;

15. Cila do të jetë rritja e transfertës (në përqindje) nga buxheti i shtetit drejt pushtetit vendor në vitet 2006, 2007, 2008 dhe 2009? Sa do të jetë në terma të GDP buxheti i plotë i pushtetit vendor në vitet 2006, 2007, 2008 dhe 2009?

16. Ju thoni se shpenzimet administrative do të përgjysmohen; sa do të jenë në terma reale për vitin 2006? Por për vitet 2007, 2008 dhe 2009 çfarë parashikon programi juaj?

17. Cfarë parashikoni me program për lidhjet elektronike (email, internet, e tjerë) në shkollat për vitet 2006, 2007, 2008 dhe 2009;

18. Cilat institucione e zyra (që ju i dini sepse i konsideroni parazitare) do të mbyllën, lista e tyre?

19. Cila është dinamika e rritjes së pagave dhe shkurtimit të diferencave (ju thoni deri në 1 me 5) në vitet 2006, 2007, 2008 dhe 2009?

20. Cfarë parashikoni si amendime të ligjit të pronave (sipas faqe 10 të programit); çfarë shume do të parashikoni në buxhet për vitet 2006, 2007, 2008 dhe 2009 për çështjen e kompensimit fizik të pronave?

21. Cili institucion do të merret me çështjen e minoriteteve (faqe 11 e programit) dhe çfarë konkretisht parashikoni për minoritetin grek?

22. A do të bëjë qeveria transparencën e aspektit financiaro-ekonomik të mediave? Si dhe kur?

23. Kur do të realizohet e-goverment dhe shërbimi on-line ose çfarë do të bëhet në vitet 2006, 2007, 2008 dhe 2009 për e-goverment e shërbimin on-line?

24. Kur do të përfundojë (sipas faqes 14) ngritja e shërbimit "një ndalin në një sportel"?

25. Cfarë parashikon qeveria për parandalimin dhe ndëshkimin e kultivuesve të drogës në Lazarat?

26. Kur përfundon regjistri themeltar i gjëndjes civile?

27. Cfarë ofron programi juaj në vitet 2006, 2007, 2008 dhe 2009 për hapjen e vendeve të reja të punës në sektorin publik e privat, në shifra dhe reformat për çdo vit?

28. Cila është dinamika e rritjes së buxhetit për arsimin dhe shëndetsinë, në terma reale e të GDP, në vitet 2006, 2007,

2008 dhe 2009?

29. Ne pergjigje te pikës 24, faqe 21, pyetje: sa do të rriten ne seicilin nga vitet 2006, 2007, 2008 dhe 2009 shpenzimet shoqërore?

30. Në vijim të pikës 26 faqe 21, pyetje: Cili është "programi vizionar e realist" dhe si të realizohet ai ne vitet 2006, 2007, 2008 dhe 2009?

31. Pika 29 faqe 21, pyetje: Cili është objektivi juaj në terma sasiorë, pra cfarë indikatorësh sasiorë ofron kjo deklaratë ne program?

32. Lidhur me deklarinimin ne faqen 24, "Mbikqyrja dhe rregullimi i sektorit financiar" të sqarohet se cfarë do të thotë me konkretisht "integrim ne nje autoritet te vetëm i enteve të rregullimit dhe mbikqyrjes së sektorti finanaciari"; kur do te behet dhe cili do të jete roli i Bankës së Shqipërisë, si institucion i pavarur?

33. Cila do të jetë sipas programit, dinamika në vite, 2006, 2007, 2008 dhe 2009 e rritjes së potencialeve kredituese të bankave sepse ju pretendoni që për katër vjet do të tre/katerfishohet ky potencial;

34. Po e njëjtë si pyetja e mësipërme per pikën "Zgjerimi i mikrokredisë" faqe 24 te programit?

35. Kur parashikoni të hapet Bursa e Tiranës, ne cilin vit?

36. Kur do të privatizohet INSIG?

37. Cfarë parqesh industriale parashikoni të hapni, ne cilin vit do te filloni, dhe ne cilat qytete/rajone?

38. Ju pretendoni se ne vitin 2009 (faqe 26 paragrafi i fundit) "gjysma e nevojave per investime do te perballohen nga FDI"; sa do te jete FDI ne vitin 2006, 2007, 2008 dhe 2009 ne terma reale e te PBB per të arritur objektivin e deklaruar?

39. Sa është sot ne PBA deficiti buxhetor dhe cili eshte ndryshimi mes kësaj vlere dhe vlerës së deklaruar nga programi juaj, prej 4% te PBB ne vitin 2009 (faqe 27)?

40. Në paragrafin "treguesit e tjerë makroekonomike" në faqen 27 ju deklaroni se "peshja e investimeve publike dhe private ne terma te PBB do te arrije 30% te PBB; sa do te jetë kjo shifër ne 2006, 2007, 2008 dhe 2009?

41. Ne program deklarohet se ne 2009, "te ardhurat buxhetore" do te arrijne 28-30 % te PBB; sa do te jene ato ne vitet 2006, 2007, 2008 dhe 2009?

42. Ne paragrafin " Me pak taksa -shkallë tatimore me te ulta " kerkohet te dihen indikatorët sasiorë të këtyre shkallëve dhe uljeve sipas viteve 2006, 2007, 2008 dhe 2009?

43. Ne program pretendohet se ne vitin 2009, shpenzimet buxhetore do te jene 33-35 %PBB ; sa do te jenë ato ne vitet 2006, 2007, 2008 ?

44. Te jepet kalendari i fillim/mbarimit të segmentit Lushnje-Vlore, Durrës-Kukës, sipas viteve 2006, 2007, 2008 dhe 2009 ?

45. Cfarë parashikohet per aksin Fier-Tepelenë ?

46. Në faqe 34 pretendohet se në katër vite do të " kryhet shtrimi dhe asfaltimi i 4000 km rruge rurale " ; pyetje : me konkretisht, sa km rruge do te shtrohen dhe sa do te asfaltohen, vecas, për seicilin nga vitet 2006, 2007, 2008 dhe 2009 ?

47. Në faqen 35 keni nje titull " Sigurimi i ujit te pijshëm për cdo familje " ; cfarë do të thotë kjo për qytetet dhe zonat rurale ; cfarë konkretisht parashikohet ne 2006, 2007, 2008 dhe 2009 ?

48. Në faqen 35 pretendohet se " brënda vitit te parë të qeverisjes (pra ne shtator 2006) do te perfundoje transferimi i plote i te drejtave te pronesisë mbi sistemin e ujësjellësave dhe kanalizimeve tek pushtetet vendore duke zgjidhur ne favor te tyre edhe cështjet e borxheve " ; pyetje : sa është fatura e borxheve dhe a do të përfshihet ne buxhetin 2006 ?

49. Ne faqen 39 thuhet se " .. u mbyllën rreth 85% e shkollave te mesme ne zonat rurale..." ; pyetje : cfarë parashikon programi juaj per këtë aspekt ne vitin 2006 e vijim ? Por per shkollat profesionale publike, meqënëse pohohet se " u zvoglua numri i tyre 6 herë.. " ?

50. Lidhur me deklarimin ne faqen 40 per pagën e mësuesve, sa do të jetë rritja ne vitin 2006?

51. Shkruesi deklaroi ne faqen 40 se "synohet ulja e numrit mesatar te nxënësve për klasë në nivelin 25-30 nxënës"; pyetje: duke marrë në konsideratë rritjen natyrale të numrit te nxënësve gjithashtu, shtrohet pyetja ky objektiv në sa shkolla të reja perkthehet dhe cilat janë afërsisht fondet e nevojshme? Që kjo të mos jetë një deklaratë që verifikohet vetëm në vitin 2009; cili është kalendari për të arritur këtë synim ne vitet 2006, 2007, 2008 dhe 2009?

52. Kur do te sigurohet kompjuterizimi dhe lidhja me internet per cdo shkolle e klasë si dhe mësimi i gjuhës angleze; cili është kalendari i veprimeve per vitin 2006, 2007, 2008 dhe 2009?

53. Faqe 46, kur dhe ku saktësisht parashikohet fillim/mbarimi i ndërtimit të aeroportit ne jug te vendit, cfarë kapaciteti?

54. Ne faqen 48 shkruesi thotë se "... do te rihapen nje rrjet shkollash te profilit agrar e agroperpunues sipas modelit amerikan" ; pyetje: pse vetëm sipas ketij modeli dhe a do te ngrihen edhe nga modele të tjera?

55. Ne faqen 49 shkruesi thotë se "rrjeti diplomatik dhe i atasheve tregëtarë..." e tjerë; pyetje: si parashikohet nga Ministria e Punëve të Jashtme ngritja e rrjetit te atasheve; sa perfaqsi, sa diplomatë; cilat janë fondet e nevojshme; cili është kalendari i veprimeve per vitet 2006, 2007, 2008 dhe 2009?

56. Në faqen 54 thuhet se " brënda mandatit 4-vjecar të qeverisjes do te eleminohen ujrat e ndotura në zonën bregdetare"; pyetje: cilat janë zonat që do të eleminohen dhe cili është kalendari veprimeve për vitet 2006, 2007, 2008 dhe 2009?

57. Në faqen 54 thuhet se "do të trajtohen me përparësi të gjithë vatrat e nxehta me nivel të lartë ndotjeje.." ; pyetje: cilat vatra (lista e objekteve) konkretisht do te trajtohen; cili është niveli i trajtimit që parashikohet nga ky program; sa është fatura financiare; dhe cili është kalendari i veprimeve per 2006, 2007,2008 dhe 2009?

58. Kur do të krijohet Fondi per Mjedisin; cfarë parashikimi për vlerën e këtij fondi në vite përfshihet në programin e qeverisë?

59. Sa parashikohet të arrijë papunësia në vitet 2006, 2007, 2008 dhe 2009? Sa vende të reja punë parashikohet te hapen nga programet e aplikuar nga maxhoranca ne vitet 2006, 2007, 2008 dhe 2009?

60. Lidhur me pagat e pensionet cili është kalendari i rritjes së tyre per vitet 2006,2007, 2008 dhe 2009 bazuar në objektivin e rritjes së pensioneve dy herë në vitin 2009;

61. Sa do të rriten mesatarisht pagat; a do të ketë indeksim të pagave për shkak të inflacionit; sa do të rritet paga minimale në vitet 2006,2007,2008 dhe 2009? Sa do të rriten pagat e ulta ne administratën publike ne vitin 2006, 2007, 2008 dhe 2009?

62. Kur do te filloje e perfundojë ndërtimi i 4000 apartamenteve per te pastrehët; sa do të ndertohen ne vitet 2006, 2007, 2008 dhe 2009?

63. Sa do të jetë fatura financiare në buxhet per të perndjekurit ne vitet 2006, 2007, 2008 dhe 2009?

64. Cdo të thotë konkretisht "mbështetje fiskale..." e veteranëve?

65. Lidhur me arsimimin e emigrantëve, të deklaruar në faqen 60, bëhet kjo pyetje: sa është fatura për vitet 2006, 2007, 2008 dhe 2009 per arsimin e femijve të emigrantëve; sa do të numri i fëmijve që do të mbulohen me këtë arsimim në vitet 2006,2007, 2008 dhe 2009?

66. Në program flitet për barazi gjinore ne faqen 61, si mendoni eshte aplikuar ky objektivi kur ne qeverine tuaj, kur per here te parë pas 50 vjet komunizëm dhe 14 vjet demokraci ka më pak gra ne qeveri, vetëm nje grua?

67. Në faqen 63 thuhet se "nënshkrimi i marrëveshjes së Asociim-stabilizimit do te behet vitin qe vjen"; pyetje: a keni ndonje afat me te sakte, cilin muaj?

68. Cfarë konkretisht do te bëhet ne vitet 2006, 2007, 2008 dhe 2009 per diplomacinë ekonomike dhe diplomacinë kulturore? Cila është fatura financiare për realizimin ne vite të ketyre dy objektivave te programit?

69. Cfarë do te behet me kontingjentin ushtarak ne Irak?

Cfarë parashikoni për vitin 2006, rritje apo zvoglim apo të njëjtin angazhim?

70. Në program nuk thuhet asgjë për marrëdhëniet me Spanjën, Suedinë, Hollandën, Danimarkën, vendet e Europës Juglindore si Bullgari e Rumani, vendet nordike e balltike anëtare të BE dhe NATO, Rusinë dhe vendet arabe, si i programoni ato në këto këtë vjet?

71. Cili do të jetë qëndrimi juaj ndaj reformës së Këshillit të Sigurimit? Do të mbështesni opsionin gjerman apo italian?

72. Cili do të jetë qëndrimi juaj ndaj Konferencës Islamike?

73. Cfarë dhe si do të arrini objektivin që shpenzimet e mbrojtjes të jenë 2% e PBB, objektiv i miratuar nga Kuvendi dhe i rëndësishëm për anëtarësim në NATO;

74. Cfarë veprimesh në nivel shteti dhe të bashkëpunimit me Maqedoni e Kroaci do të merrni në 2006 dhe 2007 në funksion të anëtarësimit në NATO?

75. Në faqen 71 shkruesi flet që brenda 100 ditëve do të realizohet "..përgjysmimi i menjëhershëm i tatimeve dhe taksave të biznesit të vogël"; pyetje: kur vijën në kuvend këto ndryshime dhe a janë konsultuar më FMN?

76. Në faqen 71 shkruesi flet për "reduktim të menjëhershëm të shpenzimeve administrative qeveritare"; sa është fatura e reduktimit dhe kur kryhet, në cilin muaj?

77. Brenda 100 ditëve shkruesi thotë në faqen 71 se do të behet "rritja e pagave dhe pensioneve"; pyetje: sa është kjo rritje, kur fillon dhe kur do të vijë projekti në kuvend?

78. Kur do të jetë gati PAB i rishikuar për të pasur një kopje në Kuvend?

Pyetje të Grupit Parlamentar të PSSH

1. Jeni angazhuar që brenda 100 ditëve të para të bëni një ristrukturim të plotë të institucioneve kryesore - a keni kryer ndonjë studim paraprak dhe vlerësim për këtë proces? Cili do të jetë modeli që keni menduar të aplikoni? A ka nevojë ky proces për përmirësim të kuadrit ligjor ekzistues?

2. Jeni angazhuar që brenda 100 ditëve të para të realizoni goditjen e grupeve të njohura kriminale. Cilat janë këto grupe? Përse kur kanë qene të njohura ju nuk keni bërë asnjë hap për të denoncuar mos veprimin e organeve kompetente?

3. Jeni shprehur për lidhje marreveshjesh bashkëpunimi me shoqërinë civile. Nuk mendoni se nënshkrimi i marreveshjeve është edhe "nënshtrim" OJQ për të bërë vegël shtesë e qeverisjes tuaj?

4. Jeni shprehur për vendosjen e menjëhershme të një bashkëpunimi kapilar me institucionet e specializuara ndërkombetare në luftën kundër krimit të organizuar dhe

trafiqeve. Ke konsideroni Ju institucione te specializuara nderkomebtare?A ka patur deri tani asistence Shqiperia nga keto insitucione ne vleresimin tuaj?

5.Keni objektiv per uljen e aksidenteve rrugore qe ne 100 ditet e para. Cilat jane masat qe do te merrni? Cili eshte objektivi konkret qe mendoni te arrini- pra sa do te jete nr. mesatar i aksidenteve (dite, muaj etj etj).

6.Angazhoheni per respektim te objektiva ve makroekonomike, fiskale dhe buxhetore te percaktuara edhe ne mareveshjen me FMN-ne.Per cilen marrevshje e keni fjalen?A mendoni se me propozimet tuaja aventureske per ulje taksash dhe rritjesh shpenzimesh, sipas deklarimeve dhe premtimeve gjate fushates elektorale, do te mund te keni marrevshje me keto insitucione?

7.Angazhimi juaj eshte qe brenda 100 diteve te filloni ristrukturimin e organeve tatimore dhe doganore.Cili eshte vleresimi juaj per reformen e kryer deri tani me asistencen e BE-se, CAM-Albania dhe DIFID-it ne keto organe? Ku konsiston fillimi,ne shkaterrimin e asaj qe eshte bere deri tani?

8.Si mendoni te ballanconi pergjysmimin e menjehershem te tatimeve dhe taksave te biznesit te vogel (i) per organet e qeverisjes vendore (ii) per te ardhurat e buxhetit te shtetit? Ne llogaritjet dhe vleresimet tuaja sa eshte impakti i ketij faktori?

9.Kur shpreheni per pergjysmim te menjehershem, cili eshte afati dhe skedula kohore per ta bere ate realitet?

10.Angazhoheni per reduktim te menjehershem te shpenzimeve administrative qeveritare.Nga llogaritjet tuaja parprake sa jane fondet qe mendoni te perfitoni nga ky reduktim ne vlere absolute?

11.Ne vleresimin tuaj per te rishikuar SKZHES -ne dhe PBA-ne me qellim perputhjen me objektivat ambicioze te programit te qeverise -konkretisht cilat jane objektivat qe do te permiresoni, krahasuar me dokumentat ekzistues dhe cilat jane masat konkrete qe garantojne plotesimin e tyre.

12.SKZHES-ja dhe PBA-ja jane dokumenta te cilat jane hartuar ne bashkepunim te ngushte me grupet e interesit, OJQ, Kuvendin

dhe padyshim jane mbeshtetur edhe nga miratimi i donatoreve.A e vleresoni qe proces i rishikimit te ketyre dokumentave nga ana juaj, eshte i mundshem te ricertifikohet sipas standarteve te larta te pjesmarrjes te aplikuara deri tani?

13.Ne program shpreheni se objektivat ambicioze do te adaptohen nepermjet hartimit te strategjive te reja sektoriale.Mos do te thote kjo qe objektivat tuaja nuk jane vetem ambicioze?

14. Brenda 100 diteve te para mendoni te hartoni strategjite e reja sektoriale - a i keni percaktuar se kush do te jene kapacitetet qe do te angazhohen per te realizuar ato dhe njeherazi burimet e financimit te tyre?

15. Angazhoheni per realizimin e nje procesi ta hapur me shoqerine civile dhe komunitetin e biznesit per hartimin dhe rishikimin e strategjive. Mendoni se deri tani ai ka qene i mbyllur?

16. Angazhoheni per pergatitjen e programit buxhetor dhe fiskal brenda muajit tetor. Vleresoni se kjo gje behet e mundur edhe ne saje te qendrushmerise dhe profesionalizmit te krijuar ne administraten publike gjate viteve te fundit te qeverisjes?

17. Premtoni se procesi i hartimit te projektbuxhetit do te behet ne konsultim te hapur si asnje here me pare. A mund te na thoni se cilat ishin procedurat qe para 1997 ju zbatonit ne hartimin e buxhetit? Konsultimet me komunitetin e biznesit, organet e qeverisjes vendor, grupet e interesit etj etj, e te institucionalizuara nga qeverisja e meparshme ne vleresimin tuaj nuk kane ekzistuar?

18. Angazhoheni se do te filloni me heret se kurre diskutimin e programit buxhetor dhe fiskal ne Kuvend. Kur premtoni qe do ta paraqisni ne Kuvend saktesisht? Kur mendoni se do te realizoni perfshirjen e aktoreve te interesit para apo pas dergimit ne Kuvend?

19. Gjate qeverisjes tuaj te meparshme kronikat vertetojne se asnjehere nuk arritet te miratonit buxhetin vjeto te vitit pasardhes brenda muajit dhjetor? Cfare garancie i jepni shqiptare qe kjo menyre te qeverisuri nuk do te rikthehet?

20. Premtoni qe do te paraqisni shume shpejt ne Kuvend programin buxhetor dhe fiskal 2006. Ne kushtet kur aktualisht nuk keni mareveshje 3 vjecare ne FMN-ne, mendoni qe do te dergoni ne Kuvend programin buxhetor para apo pas negociimit?

21. Angazhoheni te filloni pergatitjet per sezonin turistik te vitit 2006 brenda vitit 2005 nepermjet rialokimit te fondeve buxhetore. Nisur nga afatet ligjore te prokurimeve si do ta mbani kete premtim (i) afati i prokurimeve te fondeve ka qene 31 korriku. (ii) rifillimi i procedurave dhe afatet e tyre nuk sigurojne perfundim te punimeve brenda vitit 2005?

22. Angazhoheni per te realizuar nderhyrje ne infrastrukture per sherbimet baze, gjithnje ne funksion te turizmit. Cilat jane vleresimet per fonde me qellim realizimin e tyre? Nga do te sigurohen ato?

23. Do te hartoni planin e punes per furnizimin me uje 24 ore te zonave turistike brenda veres 2006. Ke konsideroni si zona turistike? Plani i punes a eshte i shoqeruar me faturen perkatese - pra sa fonde mendoni se do te angazhoni? Cilat do te jene burimet per sigurimin e tyre?

24. Angazhoheni te merrni masa llogjistike dhe institucionale, brenda 100 diteve per minimizimin e demeve nga shirat. Kush jane masat llogjistike? Kush jane permiresimet institucionale? Cili eshte vleresimi juaj per koston e ketij procesi?

25. Angazhoheni qe brenda 100 diteve do te rishikoni ligjin per kthimin dhe kompesimin e pronave dhe njekohesisht edhe fillimin e zbatimit te tij brenda vitit 2005.

Cili eshte kalendari i hapave qe keni menduar ?A mendoni se ndryshimi do te shoqerohet me rritjen e fatures financiare?

26.Si e shpjegoni qendrimin tuaj per te shtyre per vitin 2006 fillimin e trajtimit te te perndjekurve politike, nderkohe qe fondet jane disponibel ne buxhetin e shtetit te miratuar per vitin 2005. Mos vlerosoni qe ti perdorni keto fonde per qellime te tjera?

27.Angazhoheni qe gjate vitit 2006 do te permiresoni imazhin e Shqiperise ne luften kunder korrupsionit dhe krimin te organizuar.Ne cfare klasifikimi synoni te arrini?

28.Premtoni te riktheni rritjen ekonomike ne 6%. A ju kujtohet se kur u larguat nga Presidenca e kishit zhytur kete vend ne kaos dhe qe Shqiperia pati renien ekonomike me te madhe gjate gjithë viteve te tranzicionit me minus 10.2 % .Per ke rikthim e keni fjalen?

29.Premtoni rritjen ekonomike prej 6%. Si mendoni ta realizoni kete brenda vitit 2006?

30.Premtoni venien ne pune te Burses se Tiranës brenda vitit 2006. Cilat jane sherbimet financiare qe mendoni se do te realizoni nepermjet saj?

31.Angazhoheni te rrisni shkallen e decentralizimit fiskal me te pakten 30%. Cilat jane funksionet e perbashketa qe mendoni te delegoni ? Cili eshte impakti fiskal apo buxhetor i ketij procesi per vitin 2006 sipas llogaritjeve qe ju keni bere?

32.Angazhoheni per fillimin e zbatimit te reformes arsimore ne vitin 2006.Cili eshte ne vizionin tuaj permbajtja e reformes ? Dhe me qene se flitet per fillimin zbatimi a eshte e hartuar ajo? Nga kush?...

33.Qendrueshmeria makro ekonomike, privazitimi i pothuajse i plote i sistemit bankar,ritja e konkureses midis bankave, kane bere qe kreditimi i sektorit privat te rritet me ritme te larta.Ne programin tuaj ju parashikoni kater fishimin e kreditimit te sektorit privat.,Cili mendoni qe do te jeta ai faktor ekstra qe do te ndikoje ne kete performance?

34.Ne programin tuaj nga njera ane keni premtime per ulje taksash dhe tatimesh dhe nga ana tjeter per rritjen e nivelit te shpenzimeve per sektoret prioritare.I gjithë ky skenar potencialisht rrezikon tejkalimin e nivelit te deficitit ne raport me GDP te arritur deri tani.Nqs programet e politikës monetare te Bankes Qendrore nuk perputhen me kerkesen e programit te Qeverise per kreditim, si do ta zgjidhni dhe si do te perballoni mbajtjen e premtimeve te mesiperme.

Pyetje Z.Berisha

* Sfida kryesore do të jetë shteti i së drejtës - për shkak të shkeljes së Kushtetutës duke shpifur në parlament ju keni disa çështje në gjykatën e Tiranës.

Këto çështje kanë shumë zvarritje - kur do të paraqiteni duke

respektuar pavarësinë e gjyqësor?

* Ju keni akuzuar shpesh gati të gjithë ministrat duke tundur fleta boshe në parlament për një dosje të Brukselit ku akuzoheshin qeveritarët, kur jeni gati të ballafaqoheni në seancë publike me akuzat tuaja fallso dhe ku mbështet karrierën dhe fitoren tuaj elektorale?

* Po deklaroni me forcë se do të drejtoni Task Forcën kundër korrupsionit, ju jeni akuzuar për përqëndrim pushteti dhe shpërdorim pushteti politik gjatë mandatit tuaj si president.

Do t'i jepni përparësi strategjive antikorrupsion apo pushtetit absolut të një personi qoftë ky edhe kryeministri i një vendi?

A respektoni konkluzionin se pushteti absolut është absolutisht i korruptuar?

* Ju deklaroni se sipas Bankës Botërore në Shqipëri humbasin nga buxheti i shtetit 1.4 miliard dollarë sa muaj duhet të ndihet efekti në buxhet, kur vetëm për 100 ditët e para kjo shifër duhet të jetë 389 milion dollarë, ose rreth 38 miliard lekë?

* Ju keni deklaruar se vendi duhet të çdoganoj 1 milion tonë karburante ose tre herë më shumë se sot, pas sa muaj ju do të raportoni në Parlament efektet e luftës tuaj kundër kontrabandës dhe korrupsionit?

Deputeti: Arben Malaj

Pyetjet për kabinetin Berisha

* Thuhet që niveli i investimeve totale në ekonomi është 20%. Në fakt në fund të vitit 2004, të çertifikuar tashmë edhe KLSH ato janë 23.6%. Mbi cilin nga treguesit i keni mbështetur premtimet tuaja për programin 4 vjeçar?

* Në programin tuaj i referoheni nivelit të investimeve me burime të brendshme duke cituar që ai aktualisht është 2%. Ndërkohë që për vitin 2004 ky tregues është 3.54% në raport me GDP-në. Mbi cilin nga treguesit i keni mbështetur premtimet tuaja? Si do të arrini nivelin 5% në fund të mandatit dhe cili është niveli i plotësimit të këtij objekti në vite të veçanta?

* Përgjithësisht keni përcaktuar objektiva që mendoni se do t'i arrini në fund të mandatit. Ky program në këtë mënyrë bëhet i pamonitorueshëm. E keni bërë këtë për t'ju shmangur kontrollit dhe analizës në Kuvend?!

* Premtoni që defiçiti nuk do të jetë më i lartë se 4% e PBB-së? Në kushtet kur nga rreth 13% që ai ishte në vitin 1997 ne po e lëmë në nivelin e 4.92 (buxheti i vitit 2005), mos do të thotë kjo që ju nuk keni ndërmend të merrni asnjë politikë për përmirësimin e menaxhimit të defiçitit dhe uljen e mëtejshme në raport me PBB?

* Mendoni të ristrukturoni administratën doganore dhe të përmirësoni efikasitetin e saj. Cili do të jetë qëndrimi juaj në

lidhje me implementimin e ASICUD-es?

* Angazhoheni të realizoni një ulje të kostos së borxhit, duke pretenduar në uljen e defiçitit. Referuar vetë programit tuaj nuk rezulton që të keni objektiva në drejtim të uljes së defiçitit? Atëherë, si do ta mbani këtë premtim për më tepër kur gjatë kësaj periudhe normalisht kemi edhe përfundime të periudhës grace të disa marrëveshjeve dhe ne treguesit për inflacionin nuk paraqisni angazhime për përmirësim?

* Angazhoheni për të përmirësuar thellësisht sistemin e planifikimit të financave publike ndërkohë që si mekanizëm do të përdorni pikërisht Sistemin e Planifikimit të Integruar? Nuk ju duket paksa paradoksale fryma e mohimit të gjithshkaje të realizuar deri tani?

* Angazhoheni për reduktim të numrit të taksave. Cili nga taksat që aktualisht zbatohen do të hiqni? Kur do hiqni? Sa është impakti në reduktimin e të ardhurave tatimore sipas studimeve tuaja nga ky reduktim? Si do të përballoni efektin negativ të tyre?

* Premtoni uljen e tatimit të fitimit në 20%. A e dini që tashmë kjo është bërë realitet sepse Kuvendi i mëparshëm e ka miratuar?

* Në programin tuaj angazhoheni që 50% të nevojave për investime në ekonomi do të përballohen nga FDI-të. Sa janë sipas sektorëve, dhe sa rriten në raport me ritmet aktuale?

* Sa janë kostot sipas viteve për premtimet për ish pronarët, ish të përndjekurit?

1. Programi i Qeverisë Berisha atakon reforma të ndërmarra në 8 vjetët e fundit këto reforma kanë pasur si donatorë dhe monitorues partnerët ndërkombëtar, - BE, KE, USAID, WB, FMN, UNDP etj.

Pyetje: Kryeministri shqiptar i atakon drejtpërdrejt këta partnerë në vijim të politikës '92-'97 apo propozon zgjedhjen e partnerëve të rinj për të rregulluar këtë handikap?

2. Deklaroni se do të përfundohet reforma zgjedhore në bashkëpunim dhe mirëkuptim me opozitën

Pyetje- Kjo do të thotë:

- Do të pranoni komision hetimor për 3 korrikun

- Do të siguron vazhdimësi dhe konsensus për komisionin bipartizan

- Apo thjesht do të aplikoni skemën Lazarat ku votonin, kontrollin dhe numëronin vetëm përfaqësues të PD.

3. Deklaroni se do të mbyllen ose shkurtohen një rrjet i tërë institucionesh e zyrash.

Pyetje- Keni shembuj konkret apo është presion i drejtpërdrejtë mbi administratën që të bëhen shërbëtorët tuaj.

4. Dekloni se mazhoranca do të zbatojë statusin e nënpunësit civil për të gjithë ata që e kanë fituar me meritë.

Pyetje- Kriteret ligjore janë të përcaktuara qartë dhe çdonjëri nga nënpunësit civil është pranuar në bazë të ligjit, atëherë deklaroheni se do të ndryshoni ligjin dhe do të rriteni në bazë të meritave partiake.

5. Dekloni se Qeveria do të shumëfishojë buxhetin për kulturën pa përmendur asnjë shifër konkrete apo afat kohor.

Pyetje- A do t'i qëndroni minimalisht projekt-buxhetit të paraqitur nga MKRS për dyfishimin e pagave të artistëve të institucioneve kombëtare sipas një akordi dhe me sindikatat e artistëve.

6. Programi tuaj elektoral i mungon në tërësinë e vet një prononcim për rininë, a keni një koment për këtë?

7. Në program flitet për një bosht qëndror të Jugut Lushnje-Kuçovë-Gjirokastër,

Pyetje- Qeveria ashtu si në prononcimet publike gjatë fushatës, deklaron ndërprerjen e financimit të autostradës Fier-Mallakastër-Tepelenë?

Deputeti: Blendi Klosi

Pyetje për Kryeministrin Z.Sali Berisha

1. Në faqen 5 paragrafi 11 të Programit tuaj ju thoni se "progresi i sistemit demokratik në Shqipëri ka ardhur si rezultat i veprimtimit të natyreshëm të forcave progresiste të shoqërisë si dhe i mbështetjes e presionit konstruktiv të partnerëve ndërkombëtar mbi qeverisjen e viteve të fundit".

Meqenëse pranoni që sistemi demokratik ka bërë progres në Shqipëri, a jeni i mendimit se mazhoranca e djeshme për 8 vite ka dhënë kontribut për këtë progres?

2. Po në paragrafin 11 të faqes 5 ju theksoni që një sërë arsyesish si korrupsioni apo moszbatimi sa duhet i reformave "kanë shkaktuar humbjen në shkallë të gjerë dhe në nivele tepër të larta të besimit të shqiptarëve në institucionet shtetërore të cilat janë inefiçente, të dobta, jo-transparente dhe thellësisht të korruptuara.

Ku e klasifikoni në këtë rast atë pjesë të pushtetit vendor (që sot ka shumë kompetenca) në gati 50% të territorit të vendit që qeveriset nga përfaqësuesit tuaj? A keni bërë ndonjë testim se sa efikente apo cila është shkalla e besimit të qytetarëve tek autoritetet komunale, bashkiake apo të qarqeve ku drejton Partia Demokratike?

3. Në pjesën e programit që i takon sistemit zgjedhor f.6 ju deklaroni se "zgjedhjet e lira e të ndershme do të jenë burimi i vërtetë i legjitimitetit të institucioneve demokratike... Manipulimi me votën e qytetarëve do të marrë fund njëherë e përgjithmonë". Në përfundim të zgjedhjeve të 3 Korrikut 2005, ju jeni tashmë shumica qeverisëse. A ndiheni legjitimë si mazhorancë? Nëse zgjedhjet e 3 korrikut kanë qenë të manipuluar si spjegohet që jeni sot në pushtet?

4. Ju thoni se do të përfundohet reforma zgjedhore. Çfarë nënkuptohet me këtë po të keni parasysh që Kodi Zgjedhor mori bekimin tuaj?

5. Sa do t'i kursehet buxheti të shtetit nga zvogëlimi i numrit të Ministrive dhe sa është numri i vendeve të punës që suprimohen nga ky zvogëlim?

6. Cili është shkaku i vërtetë i suprimimit të MPVD po të kemi parasysh që reforma e decentralizimit është në pikun e saj?

7. Si e vlerësoni legjislacionin aktual për nëpunësit civilë dhe ç'mendim keni për reformën e 8 viteve të fundit në këtë fushë, e bërë kjo me asistencë ndërkombëtare? Gjykoni që janë hedhur hapa pozitive?

8. Çfarë keni parasysh kur thoni se "Qeveria do të kryejë një reformë thellë e të vërtetë të administratës publike"? (f.9)

9. Cili është rrjeti i tërë i institucioneve dhe zyrave parazitare që do të mbyllen ose shkurtohen?

10. A ka ndonjë Ministri apo institucion qëndror në varësi të Qeverisë që nuk do të preket nga ristrukturimi, pra do të mbetet siç është?

11. Çfarë keni parasysh kur thoni në faqen 10 se "Mazhoranca e re njeh dhe respekton statusin e nëpunësit civil të çdo punonjësi që e ka fituar atë me meritë dhe ai do të jetë i garantuar"? Si do të përcaktoni cilët janë punonjësit që e kanë fituar me meritë statusin e nëpunësit civil? Cili do të jetë kriteri?

Deputeti Taulant Dedja

Pyetje për Ministrin e Brendshëm Z.Sokol Ollidashi

1. Cila është struktura (dhe organigrama e saj) e cila do të mbulojë në Ministrinë tuaj pushtetin vendor. Sa vende pune nga MPVD aktuale do të suprimohen?

2. A mund të komentoni paragrafin e programit të qeverisë tuaj (f.17) "Organet e rendit publik do t'i nënshtrohen një reforme të thellë në organizimin, shpërndarjen, komandimin, marrëdhëniet me komunitetin, përgatitjen profesionale dhe sigurimit të burimeve njerëzore si dhe do të bëhen të afta të japin edhe shërbime speciale të sigurisë"?

3. Cili është pozicioni i Qeverisë tuaj për projektet e

diskutuara deri më sot në lidhje me një reformë të mundshme administrativo-territoriale?

Deputeti : Taulant Dedja

Pyetje për Ministrin e Drejtësisë Z.Aldo Bumçi

1. Në faqen 7 të Programit, Paragrafi Drejtësia ju thoni që "Reformat në Drejtësi do të synojnë të rikthejnë besimin e shqiptarëve në sistemin gjyqësor dhe në ndershmërinë e paanësinë e vendimit gjyqësor". Ju pra flisni për rikthim besimi në sistemin gjyqësor. Cilës periudhë i referoheni kur ka ekzistuar ky besim që duhet rikthyer? Periudhës para vitit 1992 apo '92-'97?

2. Po në Paragrafin Drejtësia f.7 a mund ta shpjegoni kuptimin e fjalisë që paraqet një nga drejtimet në gjerësi dhe thellësi të Reformës në sistemin e drejtësisë si më poshtë. Çfarë nënkuptoni me "forcim i përgjegjshmërisë së vendimit gjyqësor nëpërmjet rritjes së transparencës dhe aksesit, publikimit të plotë të vendimeve gjyqësore, përmirësimit të sistemit të vlerësimit të performancës së gjyqtarëve dhe të përgjegjshmërisë së tyre para ligjit bazuar në kritere objektive"?

Deputeti: Taulant Dedja

Pyetje për Ministrin e Mjedisit Z.Lufter Xhuveli

1. Cilat janë projektet e Ministrisë tuaj për uljen e nivelit të ndotjes së mjedisit në zonën përreth qytetit të Elbasanit?

2. Cili do të jetë qëndrimi juaj në rast se industritë e rënda që ndotin mjedisin në zonën përreth qytetit të Elbasanit nuk respektojnë detyrimet që u takojnë?

Deputeti: Taulant Dedja